

**KARTELĀ ŠĒĢERU SEŠĢ PRAKTIKES**

Shënim i fundës: *Në gjatë Rezolutë*

NY Prot 1310/15-16 11 025

(strukture të tjera  
të ngarkuara)

Me potosi:

A fatt: ☐ Normale (7 anni)

Date 17.11.025 No. Prot. 2113

U njohën Anëtarët

1

2

3.

4.

Manrē nē dōstēzēn

Kalon për trajtë (shprehje)

Me parosmē:

March 27 1900

Kalender für 1977 (Sonntage)

Me peronije

Maie ne dăruie

Kalon pār šajiem (strādniekiem)

Me potrošine:

Marre nã d'obezim

Address: 2511 E. 1st St.,  
Berkeley, Calif. 94712



Page 1 of 1  
Date: 10/10/10

Report 1: 10/10/10  
Report 2: 10/10/10  
Report 3: 10/10/10  
Report 4: 10/10/10

10/10/10  
10/10/10  
10/10/10

10/10/10  
10/10/10  
10/10/10  
10/10/10

10/10/10

10/10/10

10/10/10

10/10/10

10/10/10

10/10/10





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SHËRBIMI LEGJISLATIV  
SHËRBIMI JURIDIK

Nr. 1310/3 Prot.

Tiranë, më 14.11.2025

Lënda: Dërgim rezolute

AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH- SIGURIMIT TË SHITETIT

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2024”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHEM

KRYETARI

Niko PELESHI



**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH- SIGURIMIT TË SHETIT PËR VITIN 2024**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në përmbushje të misionit të tij për dhënien e informacionit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, në mënyrë që të edukojë publikun e të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën, pajtimin e përgjegjësinë për brezat e ardhshëm;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendase dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Autoritetit;

**Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit për vitin 2024 në drejtim të:**

Hartimit të projektvendimit “Për përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur ose të ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara të personave të zhdukur në këtë periudhë”.

Intensifikimit të punës ndërgjegjëse me pushtetin vendor me qëllim zbatimin korrekt të ligjit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh.

Rritjes së numrit të njësive arkivore të klasifikuara “sekret shtetëror” që janë deklasifikuar.

Intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit.

Ndërveprimi me institucionet homologe ndërkombëtare përmes pjesëmarrjes aktive në platforma evropiane, me qëllim promovimin e transparencës arkivore dhe studimin shkencor të historisë.

**Kuvendi rekomandon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2025:**

1. Të angazhohet në digjitalizimin e plotë të fondit arkivor për të garantuar ruajtjen afatgjatë dhe aksesin publik të dokumenteve.
2. Të vijojë angazhimin për përfshirjen e pushtetit lokal në njohjen e rezultateve të verifikimeve administrative lidhur me gjetjen e vendvarrimeve të dyshuara dhe mbrojtjen e vendvarrimeve të identifikuara.
3. Të vijojë angazhimin për krijimin e një baze të vetme të dhënash për personat e zhdukur dhe ta bëjë atë publike e të aksesueshme për publikun.
4. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit.
5. Të konkretizojë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, me qëllim zbatimin korrekt të ligjit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh.
6. Në kuadër të edukimit qytetar, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit të angazhohet për të përfshirë në programin mësimor, orë ekstrakurrikulare në shkolla, me qëllim edukimin e të rinjve për të kaluarën komuniste dhe pasojat e saj.
7. Të angazhohet në bërjen funksionale të Mediatekës (Platforma *online* e arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit), me qëllim promovimin e materialeve arkivore dhe dokumenteve historike për të lehtësuar studimin dhe informimin për periudhën e diktaturës në Shqipëri, si dhe rritjes së aksesit në dokumente nga ana e institucioneve arsimore.

Miratuar në datën 6.11.2025

